# AKT - THEMELIMI

## I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI KUFIZUAR

## "STE-LA 2000" SHPK.

Ne qytetin Fier, sot ne daten 28.04.2000, ne ortaket e poshteshenuar

1-**FEJZI LAMAJ** i biri i Jasharit dhe i Lufties, lindur me 1970 ne Cakran te rrethit Fier dhe banues ne Fier, lagja "15 Tetori", rruga "Mujo Ulqinaku", pall.60, i martuar me femije,

DHE

2-**GJERGJI STEFANI** i biri i Thomait dhe i Ollges, lindur me 1969 ne Erseke dhe banues ne Fier, lagja "Liri", rruga "Jakov Xoxa", pall. 104, i martuar pa femije,

me vullnetin tone te lire, hartojme kete akt-themelimi per krijimin e shoqerise tregetare private, me pergjegjesi te kufizuar, me emrin "STE-LA 2000" shpk., si me poshte:

### NENI 1

**BAZA LIGJORE:**

1.1. Ky akt-themelimi bazohet ne legjislacionin shqiptar ne pergjithesi dhe ne vecanti ne ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", ne ligjin Nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrimin ne rregjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare" si dhe aktet nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

### NENI 2

**FORMA DHE EMRI.**

2,1. Shoqeria do te jete e formes me prgjegjesi te kufizuar dhe me emrin "STE-LA 2000" shpk.

2.2. Me vendim te Asamblese Ortakeve, shoqeria mund te shndrohet nga nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne nje lloj tjeter, ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

### NENI 3

**QENDRA ADMINISTRATIVE.**

3.1. Shoqeria do te kete qendren e saj administrative ne qytetin Fier.

3.2. Me vendim te Asamblese Ortakeve, qendra administrative e shoqerise mund te ndryshoj ne nje qytet tjeter.

3.3. Shoqeria ka te drejte te hap filiale dhe zyra perfaqesimi ne rrethe te jera brenda vendit ose jashte tij, me vendim te Asamblese Ortakeve.

### NENI 4

**KOHEZGJATJA.**

4.1. Shoqeria do te kryej aktivitetin e saj per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

4.2.Data e fillimit te ketij aktiviteti(afatit) do te jete data e rregjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar,prane Gjykates se Rrethit Tirane,e si date perfundimi do te jete data e crregjistrim: te saj nga ky rregjister.

NENI 5

PERSONALITETI JURIDIK.

5.1.Shoqeria fiton personalitetin e saj juridik,ose eshte e afte te ma persiper te drejta dhe detyrime,ne daten efektive,qe eshte data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregetar.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE.

6.1.Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Projektim dhe ndertim i objekteve te ndryshme,rrugeve,ujesjellesa kanalizime.

-Rikonstruksion te objekteve te ndryshme.

-Prodhim dhe tregetim materjale te ndertimit.

-Import-eksport e tregetim mallra te ndryshem.

6.2.Me vendim te Asamblese Ortakeve,shoqeria mund te shtoj ose pakesaj objektin e saj te veprimtarise.

NENI 7

KAPITALI THEMELTAR.

7.1.Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(Njeqind mije) leke.

7.2.Ky kapital do te depozitohet prane Bankes se Kursimeve,Dega Fier dl do te konsiderohet si 10 pjese me vlere nominale nga 10.000 leke se cila pjese.

7.3.Kontributi i sejcilit ortak eshte 50.000 leke ose nga 5 pjese me vl re nominale nga 10.000 leke sejcila pjese.

7.4.Shpqeria ka te drejte te rrit ose zvogeloj kapitalin themeltar,me vendim te Asamblese se Ortakeve dhe ne perputhje me ligjin.

7.5.Cdo rritje ose zvogelim i kapitalit themeltar do te jete kontribut i sejcilit ortak ne masen 50%.

7.6.Shoqeria,me vendim te Asamblese Ortakeve,mund te shese,te transfer ose te bashkoj pjese te kapitalit te saj ose te gjithe kapitalin,me nje ose me shume persona te tjere fizik a juridik,vendas ose te hu

7.7.Cdo ortak ka te drejte qe pjesen e tij te kapitalit themeltar ne sl qeri,t'ja shese ortakut tjeter ose nje personi tjeter fizik a juridik,vendas ose te huaj,ne perputhje me ligjin.

NENI 8

NDARJA E FITIMIT.

8.1.Fitimi neto i realizuar nga shoqeria,do te ndahet midis dy ortakev ne menyre te barabarte nga 50% sejcili.

8.2.Asambleja e Ortakeve mund te vendose qe asnje pjese e fitimit te
mos ndahet midis ortakeve,deri sa te shlyhen humbjet ose huate e
trasheguara nga viti i kaluar.

8.3.Shoqeria,me vendim te Asamblese se Ortakeve,mund te vendose qe nj
pjese te fitimit ose te gjithe fitimin e realizuar nga shoqeria,t
perdore per rritjen e kapitalit dhe te aktivitetit te saj.

NENI 9

ADMINISTRIMI:

9.1.Shoqeria do te administrohet nga organet e saj drejtuese,qe jane:

-Asambleja e Ortakeve.

-Administratori i shoqerise,qe eshte ortaku Fejzi Lamaj.

9.2.Te drejtat dhe detyrat e sejcilit organ,jane te percaktuara ne
statutin e shoqerise.

NENI 10

PUNESIMI:

10.1.Shoqeria,ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi,ka te dr
jte te punesoj specialiste ose punonjes te tjere.

NENI 11

AKTIVITETI FINANCJAR.

11.1.Shoqeria do te kryej aktivitetin e saj financjar ne perputhje me
ligjin "Per kontabilitetin" ne fuqi,si dhe aktet e tjera ligjore e ne
ligjore qe rregullojne keto mardhenie.

11.2.Shoqeria do te nxjere bilancin e saj financjar per cdo vit fiska
me eksperte te zgjedhur e te miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

11.3.Viti fiskal i shoqerise eshte viti kalendarik,i cili fillon me
01 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti.

11.4.Viti i pare fiskal fillon ne daten e rregjistrimit te shoqerise
ne rregjistrin tregetar dhe perfundon me 31 dhjetor te atij viti
ndersa viti i fundit fillon me 01 janar dhe perfundon ne daten e
crregjistrimit te shoqerise nga rregjistri tregetar.

11.5.Shoqeria,me vendim te Asamblese se Ortakeve,per zhvillimin e zg
rimin e aktivitetit te saj,mund te marre kredi e hua nga persona
fizike a juridike,vendas ose te huaj.

NENI 12

TE TJERA.

12.1.Asnje nga ortaket nuk ka te drejte te ndryshoje kushtet e perca
uara ne kete akt-themelimi,ne menyre te njeaneshme,pa miratim t
Asamblese se Ortakeve,ne te kundert konsiderohen te pavlefshme.

12.2.Ky akt-themelimi eshte i vlefshem sebashku me statutin e shoqer

12.3.Ky akt-themelimi u perpilua ne 5 kopje ne gjuhen shqipe,nga te